



This programme is funded
by the European Union



SHIFRA DHE FAKTE

PERCEPTIMET MBI DHUNËN KUNDËR GRAVE DHE VAJZAVE

Një përmbledhje krahasuese
(Vlerësimi fillestar, afatmesëm dhe përfundimtar)

Shënim

Ky dokument u realizua përmes programit “Fund Dhunës ndaj Grave në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi. Zbatojmë Standartet, Ndryshojmë Mendësitë”, financuar nga Komisioni Evropian dhe zbatuar nga UN Women.

Mendimet e shprehura në këtë studim u përkasin autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e UN Women apo të Komisionit Evropian.

Shkurt 2021

SHQIPËRI Shifra dhe Fakte


Të dhënat e paraqitura janë mbledhur në vitin **2020** (nëntor - dhjetor), si pjesë e një **vlerësimi përfundimtar** të zhvilluar nga **Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve (Observatori)** në kuadrin e Programit Rajonal EU-UN Women “Zbatojmë Normat, Ndryshojmë Mendësitë”. Të dhënat përfshijnë përgjigjet e mbledhura nga anketimi i 1260 individëve - gra, vajza, burra, djem dhe të tjerë, të moshave 15 – 64 vjeç, në Qarkun e Elbasanit dhe bashkitë e Durrësit, Korçës, Shkodrës, Kamzës, Tiranës dhe Vlorës, në zonat urbane dhe rurale, duke përfshirë dhe persona nga komunitetet e marginalizuara (Rome, Egjiptiane, personat me aftësi të kufizuara, dhe LGBTI). Përzgjedhja e këtyre zonave u bazua në zbatimin e projekteve dhe ndërhyrjeve në këto zona nga pjesa tjetër e OJF-ve, pjesë e programit rajonal të EU-UN Women. *Grupet e marginalizuara dhe vulnerabël përfaqësojnë 8% të kampionit, duke përfshirë: individët me aftësi të kufizuara, anëtarë të komuniteteve Rome/ Egjiptiane, persona të LGBTI.*

Të dhënat sasiore të mbledhura, nëpërmjet formateve të unifikuara dhe standardizuara dhe të aprovuara të UN Women në të gjitha vendet ku zbatohet programi (6 vende të Ballkanit Perëndimor dhe Turqia), janë hedhur në një bazë të dhënash për Shqipërinë. Të dhënat sasiore janë analizuar dhe krahasuar me qasjet e ngjashme (faza e vlerësimit fillestar e zhvilluar në 2018 dhe faza e vlerësimit afatmesëm e zhvilluar në 2019), duke përdorur të njëjtat mjete dhe metodologji. Ky dokument përfaqëson gjetjet dhe analizat krahasuese midis të dhënave nga vlerësimi fillestar (2018), afatmesëm (2019) dhe ai përfundimtar (2020).

Njohja e Ligjit/ Informacion rreth Ligjit/ Familjariteti me Ligjin

- **65% e të anketuarve kishin njohuri mbi ekzistencën e një ligji mbi barazinë gjinore, 81% e tyre kishin njohuri mbi ekzistencën e një ligji mbi dhunën kundër grave dhe dhunën në familje.** Krahasuar me gjetjet e anketimit të kryer gjatë fazës së vlerësimit fillestar (2018) dhe vlerësimit afatmesëm (2019) u evidentua që:
 - Përgjatë fazës së vlerësimit përfundimtar (2020), niveli i ndërgjegjësimit për ekzistencën e ligjit mbi barazinë gjinore është ulur me **0.6%** (gjatë fazës së vlerësimit fillestar ishte 65.4%);
 - Përgjatë fazës së vlerësimit përfundimtar (2020), niveli i ndërgjegjësimit për ekzistencën e ligjit mbi dhunën kundër grave dhe dhunën në familje është rritur me **3.3%** (gjatë fazës së vlerësimit fillestar ishte 78.4%).
 - Ndërkohë përgjatë fazës së vlerësimit afatmesëm (2019), niveli i ndërgjegjësimit për ekzistencën e këtyre dy ligjeve ka qenë më i lartë se në fazën e vlerësimit fillestar dhe atij përfundimtar (ndërgjegjësimi për ekzistencën e ligjit mbi barazinë gjinore ka qenë 77% ndërsa për ligjin mbi dhunën kundër grave ka qenë 83%).

Grafiku 1- “Rezultatet krahasuese për nivelin e ndërgjegjësimit për ekzistencën e ligjit për bazazinë gjinore dhe ligjit kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës familjare”



- Nga gjetjet e sondazhit të kryer gjatë **fazës së vlerësimit përfundimtar (2020)** u evidentua që:
 - Një pjesë e të anketuarve nuk ishin të ndërgjegjshëm se format e tjera të dhunës jo-fizike ishin të dënueshme me ligj. Pjesa më e madhe e të anketuarve e dinte që disa lloje të caktuara të dhunës ishin të ndëshkueshme me ligj (duke renditur nga përqindja më e lartë në atë më të ulët):


▪ Përdhunimi / sulmet seksuale	93%
▪ Trafikimi dhe shfrytëzimi seksual	92%
▪ Abuzimi seksual i fëmijëve	92%
▪ Ngacmimi seksual	88%
▪ Dhuna në familje	80%
▪ Krimet për “mbrojtjen” e nderit	77%
▪ Ndjekja	65%
▪ Dhuna Psikologjike	62%
▪ Aborti i detyruar	55%
▪ Martesat e detyruara	52%
▪ Dhuna Ekonomike	48%
 - Dhuna ekonomike, martesat e detyruara dhe aborti i detyruar sërish konsiderohen në nivel të ulët si forma dhune të dënueshme nga ligji (niveli i ndërgjegjësimit të individëve që këto janë forma dhune të ndëshkueshme me ligj është 48-55%). Për format e tjera të dhunës dhe ndëshkueshmërisë së tyre me ligj, niveli i ndërgjegjësimit ishte më i lartë gjatë fazës së vlerësimit përfundimtar (62-93%).
 - **Përdhunimi martesor perceptohet ndryshe nga krimet e tjera.** Ndërsa pjesa më e madhe e të anketuarve gjatë fazës së **vlerësimit përfundimtar (2020)** i konsiderojnë trafikimin dhe shfrytëzimin seksual si krime duke besuar që një person do të dënohej për kryerjen e tyre (92%), një përqindje më e vogël e të anketuarve besonte që një person do të dënohej për kryerjen e marrëdhënieve seksuale me forcë me bashkëshorten/ partneren e vet (69%).

Krahasuar me gjetjet e sondazhit të kryer gjatë fazës së *vlerësimit fillestar (2018)*, u evidentua që përqindja e të anketuarve që beson se një person duhet të ndëshkohet për kryerjen e marrëdhënieve seksuale me forcë me bashkëshorten/partneren është rritur **me 23.2%** (ishte 56% më parë). Ndërkohë kjo vlerë ka qenë më pozitive gjatë fazës së *vlerësimit afatmesëm (2019)*, në të cilën 71.4% e të anketuarve e konsideronte një akt të dënueshëm me ligj kryerjen e marrëdhënieve seksuale me forcë me bashkëshorten/ partneren e vet.



69% e të anketuarve besojnë se një person do të ndëshkohet nëse e detyron bashkëshorten/ partneren të kryejë marrëdhënie seksuale me forcë.

Grafiku 2- “Rezultatet krahasuese për nivelin e besimit të të anketuarve për ndëshkimin e personave që detyrojnë bashkëshortët/partnerët të kryejnë marrëdhënie seksuale me forcë”



Perceptimet e roleve gjinore

- Në fazën e vlerësimit përfundimtar, rezultoi se një numër i konsiderueshëm i të anketuarve besojnë se vajzat/ gratë pritet të veprojnë brenda roleve tradicionale gjinore dhe të jenë të nënshtruara.

28% e të anketuarve besojnë se vajzat/ gratë i përkasin sferës shtëpiake, ndërsa djemtë/ burrat duhet të ndjekin mundësitë e karrierës. Të dhënat tregojnë që:


- **71%** e të anketuarve nga komuniteti Rom/Egjiptian besojnë se vajzat i përkasin sferës shtëpiake;
- **13%** e individëve me aftësi ndryshe besojnë se vajzat i përkasin sferës shtëpiake;
- **Më pak se 1 në 3 të anketuar** beson se vajzat/ gratë i përkasin sferës shtëpiake, ndërsa djemtë/ burrat duhet të ndjekin karrierën dhe mundësitë e lidërshiptit. Ky raport është *i njëjtë* si në fazën e vlerësimit fillestar dhe afatmesëm. Ndërsa nga analiza gjinore rezultoi që:

- **Afërsisht 1 në 3 djem/ burra të anketuar** beson se vajzat/ gratë i përkasin sferës shtëpiake, ndërsa djemtë/ burrat duhet të ndjekin karrierën dhe mundësitë e lidërshiptit. Përqindja e djemve/ burrave të anketuar që besojnë se vajzat/ gratë duhet të merren kryesisht me punët e shtëpisë, ndërsa djemtë/ burrat duhet të ndjekin karrierën dhe mundësitë e lidërshiptit **ka rënë me 6%** në krahasim me fazën e vlerësimit fillestar (tashmë 31% e djemve/ burrave të anketuar e besojnë këtë, në krahasim

me 33% të djemve/ burrave të anketuar në vlerësimin fillestar). Ndërkohë ky tregues ka qenë më pozitiv në fazën e vlerësimit afatmesëm me 29%.

- **Afërsisht 1 në 4 vajza/ gra të anketuara** beson se vajzat/ gratë i përkasin sferës shtëpiake, ndërsa djemtë/ burrat duhet të ndjekin karrierën dhe mundësitë e lidërshiptit. Përqindja e vajzave/ grave të anketuara që besojnë se vajzat/ gratë duhet të merren kryesisht me punët e shtëpisë, ndërsa djemtë/ burrat duhet të ndjekin karrierën dhe mundësitë e lidërshiptit **ka rënë me 4%** në krahasim me fazën e vlerësimit fillestar (tashmë 24% e vajzave/ grave të anketuara e besojnë këtë, në krahasim me 25% të vajzave/ grave të anketuara në vlerësimin fillestar). Ndërkohë ky tregues në fazën e vlerësimit afatmesëm ka qenë 24.7%.

Grafiku 3- “Rezultatet krahasuese për nivelin e besimit që vajzat/ gratë i përkasin sferës shtëpiake”



- **Djemtë/ burrat perceptohen të kenë “me të drejtë” rol dominues dhe të kenë pushtet mbi vajzat/ gratë.**
 - *Kontroll mbi trupin e grave:* Më shumë se 1 në 6 vajza/ gra të anketuara bien dakord që gratë duhet të kryejnë marrëdhënie seksuale me bashkëshortët e tyre pavarësisht nga dëshira e tyre. Në mes të vajzave/ grave të anketuarave Rome/ Egjiptiane ky besim është më i lartë, pasi pothuajse 1 në 3 të anketuara bie dakord që gratë duhet të kryejnë marrëdhënie seksuale me bashkëshortët e tyre pavarësisht nga dëshira e tyre. Pothuajse 1 në 9 djem/ burra të anketuar besojnë se vajzat/ gratë duhet të vizitohen tek doktorët vetëm me lejen e partnerëve të tyre. Krahasuar me gjetjet e sondazheve të zhvilluar gjatë **vlerësimit fillestar (2018) dhe vlerësimit afatmesëm (2019)**, u evidentua që:
 - Raporti i djemve/ burrave të anketuar që besojnë se vajzat/ gratë duhet të vizitohen tek doktori vetëm me lejen e partnerëve të tyre është përmirësuar përgjatë fazës së vlerësimit përfundimtar (1 në 9 djem/ burra të anketuar). Ndërsa në dy fazat e mëparshme ky raport ishte 1 në 5 djem/ burra të anketuar.

- *Kontroll mbi financat e grave:* Në mënyrë të dukshme, 1 në 4 djem/ burra të anketuar dhe më shumë se 1 në 6 vajza/ gra të anketuara besojnë që të ardhurat e vajzës/ graas janë pronë e partnerit. Afërsisht 1 në 6 djem/ burra të anketuar dhe më shumë se 1 në 7 vajza/ gra të anketuara besojnë që gratë i përkasin burrave të tyre dhe familjeve të burrave dhe si pasojë nuk mund të trashëgojnë pasuri nga familja e tyre e lindjes. Krahasuar me gjetjet e sondazheve të kryera në fazën e *vlerësimit fillestar (2018) dhe vlerësimit afatmesëm (2019)*, u evidentua që:
 - Raporti i burrave dhe grave të anketuara që besojnë se të ardhurat e grave janë pronë e burrave të tyre është përmirësuar gjatë fazës së vlerësimit përfundimtar (ka qenë 1 në 3 djem/ burra dhe 1 në 4 vajza/ gra që ka qenë në dy fazat e mëparshme).
 - Perceptimi që gratë i përkasin burrit dhe familjes së tij është përmirësuar, sikurse tregon sondazhi i vlerësimit përfundimtar:
 - 1 në 6 djem/ burra të anketuar në vitin 2020 krahasuar me 1 në 4 djem/ burra të anketuar në vitin 2019 dhe me 1 në 5 djem/ burra të anketuar në vitin 2018.

- *Kontroll mbi vendimarrjen bazike dhe autonominë:* Pothuajse 1 në 6 djem/ burra të anketuar pohojnë që fëmijët e çiftit i përkasin partnerit mashkull dhe familjes së tij. Më shumë se 1 në 3 vajza/ gra të anketuara dhe 1 në 2 djem/ burra të anketuar besojnë se gratë duhet t’ju binden burrave të tyre. Krahasuar me gjetjet e sondazheve të zhvilluar gjatë *vlerësimit fillestar (2018) dhe vlerësimit afatmesëm (2019)*, u evidentua se:
 - Raporti i djemve/ burrave të anketuar që besojnë se fëmijët e çiftit i përkasin babait dhe familjes së tij është përmirësuar gjatë vlerësimit përfundimtar në krahasim me vlerësimin fillestar dhe afatmesëm (në të cilat raporti ka qenë i njëjtë 1 në 5 djem/ burra).
 - Momentalisht, raporti i djemve/ burrave si dhe vajzave/ grave që besojnë se gratë duhet t’u binden burrave të tyre është i njëjtë si në fazën e *vlerësimit fillestar (2018) dhe më i lartë se në fazën e vlerësimit afatmesëm (2019)*, konkretisht:
 - Në 2020 dhe 2018, 1 në 2 djem/ burra të anketuar beson që gratë duhet t’ju binden burrave të tyre. Ndërsa në 2019 ky raport ka qenë 1 në 3 djem/ burra të anketuar.
 - Në 2020 dhe 2018, 1 në 3 vajza/ gra të anketuara beson që gratë duhet t’ju binden burrave të tyre. Ndërsa në 2019 ky raport ka qenë 1 në 4 vajza/ gra të anketuara.

Qëndrimet ndaj dhunës kundër grave


- **Një përqindje domethënëse e të anketuarve kanë paragjykime që justifikojnë dhe minimizojnë impaktin e dhunës kundër grave.** Këto besime dhe mite reduktojnë përgjegjësinë e “dhunuesit” duke e zhvendosur një pjesë të përgjegjësisë dhe fajit mbi viktimën e dhunës. Shembull i dukshëm i këtij besimi është fakti që 27.5% e djemve/

burrave të anketuar dhe 12.6% e vajzave/ grave të anketuara besojnë gjithashtu se edhe vetëm dyshimi për tradhëti bashkëshortore përbën një “arsye të mirë” për një burrë për të goditur partneren e vet.

Krahasuar me gjetjet e sondazheve të zhvilluara gjatë *vlerësimit fillestar (2018) dhe vlerësimit afatmesëm (2019)*, u evidentua që:

- Përqindja e djemve/ burrave të anketuar të cilët besojnë se dyshimi për tradhëti bashkëshortore është një “arsye e mirë” për të goditur partneren është **rritur me 20.6%** (kjo shifër ishte 22.8% në vlerësimin fillestar). Ky tregues ka qenë më pozitiv në fazën e vlerësimit afatmesëm, në të cilin 21.9% e djemve/ burrave të anketuar kishin një besim të tillë (duke u ulur me 3.9% në krahasim me fazën e vlerësimit fillestar).
- Përqindja e vajzave/ grave të anketuara të cilat besojnë se dyshimi për tradhëti bashkëshortore është një “arsye e mirë” për të goditur partneren është **ulur me 25.9%** (kjo shifër ishte 17% në vlerësimin fillestar). Ky tregues ka qenë dhe më pozitiv në fazën e vlerësimit afatmesëm, në të cilin 9.3% e vajzave/ grave të anketuara kishin një besim të tillë (duke u ulur me 45.3% në krahasim me fazën e vlerësimit fillestar).

Grafiku 4- “Rezultatet krahasuese për nivelin e besimit të të anketuarve që dyshimi për tradhëti përbën një “arsye të mirë” për të goditur partneren”



- **Dhuna perceptohet si një çështje private që duhet të adresohet brenda familjes.** Më shumë se treçetë e të anketuarve (78%) pranojnë se gratë e abuzuara nuk duhet të kërkojnë ndihmë në polici. Ky tregues ka qenë më pozitiv në fazën e vlerësimit afatmesëm (2019), në të cilën më shumë se çetë e të anketuarve ka patur një qendrim të tillë.


Gatishmëria për të parandaluar ose raportuar dhunën

- **Shumë të anketuar hezitojnë të ofrojnë ndihmë në situata dhune.**
- **Të anketuarit ishin më pak të gatshëm të ndihmojnë në parandalimin e dhunës kundër anëtarëve të komuniteteve të marginalizuara,** duke theksuar sesi forma të

tjera të diskriminimit në bazë të etnisë ose orientimit seksual lejojnë dhe promovojnë dhunën kundër grave. **Vetëm 20% e djemve/ burrave të anketuar dhe 31% e vajzave/ grave të anketuara u treguan të gatshëm për të ndërmarrë masa për të parandaluar dhunën ndaj personave LGBTI.** Krahasuar me gjetjet e sondazheve të kryera gjatë *vlerësimit fillestar (2018) dhe vlerësimit afatmesëm (2019)*, u evidentua që:

- Përqindja e djemve/ burrave të anketuar të gatshëm për të ndërmarrë veprime për të parandaluar dhunën kundër personave LGBTI **është ulur me 28.6%** (ishte 28% në *vlerësimin fillestar*). Ndërkohë ky tregues ka qenë më pozitiv në fazën e vlerësimit afatmesëm, në të cilin 48% e djemve/ burrave të anketuar ishin të gatshëm për vepruar kundër dhunës ndaj personave LGBTI.
- Përqindja e vajzave/ grave të anketuara të gatshme për të ndërmarrë veprime për të parandaluar dhunën kundër personave LGBTI **është ulur me 27.9%** (ishte 43% në *vlerësimin fillestar*). Ndërkohë ky tregues ka qenë më pozitiv në fazën e vlerësimit afatmesëm, në të cilin 59.7% e vajzave/ grave të anketuara ishin të gatshme për vepruar kundër dhunës ndaj personave LGBTI.

Grafiku 5- “Rezultatet krahasuese për nivelin e gatishmërisë së të anketuarve për të ndërmarrë masa për të parandaluar dhunën kundër personave LGBTI”



- **Gratë treguan gatishmëri më të lartë se burrat për të ndërhyrë në situata dhune dhe për të marrë masa për parandalimin e dhunës.** Përveç gatishmërisë së rritur për të ndihmuar të panjohurit që përjetonin dhunë, gratë ishin në mënyrë të theksuar më të gatshme për të ndihmuar individë nga komunitetet e marginalizuara, si LGBTI, minoritetet etnike.
- **Qëndrimet që minimizojnë ose justifikojnë dhunën kundër grave të marginalizuara nuk kufizohen vetëm tek grupet e marginalizuara, por drejtohen ndaj të gjitha grave.**


E përbashkëta e diskutimeve mbi DHNG/V dhe barazinë gjinore

- **Çështjet që lidhen me dhunën kundër grave dhe vajzave rrallë diskutohen jashtë rrethit familjar ose atij të miqve të ngushtë.** Dhuna kundër grave dhe vajzave vazhdon

të mbetet një çështje private në Shqipëri. Të anketuarit kishin më të ngjarë t'i diskutonin këto çështje me shoqet/ shokët dhe partnerët/ bashkëshortet e tyre.

- Përqindja e të anketuarve që pranojnë të diskutojnë çështje që lidhen me dhunën kundër grave dhe vajzave me prindërit e tyre **është 27%** (ishte 10% në vlerësimin fillestar dhe 32% në vlerësimin afatmesëm).
- Përqindja e të anketuarve që pranojnë të diskutojnë çështje që lidhen me dhunën kundër grave dhe vajzave me fëmijët e tyre biologjikë djem **është 17%** (ishte 8% në vlerësimin fillestar dhe 19% në vlerësimin afatmesëm). Një mënyrë për të reduktuar DHNGV është nëpërmjet përfshirjes së djemve në aktivitete edukuese dhe ndërgjegjësuese që në moshë të hershme. Por nëse prindërit nuk pranojnë të diskutojnë me djemtë e tyre këto çështje që herët në jetë, çdo ndërhyrje në këtë fushë do të jetë më e vështirë. Për këtë arsye, paralelisht me ndërhyrjet në shkollë ose në sistemin e arsimit, duhet punuar ngushtësisht dhe me prindërit.
- Përqindja e të anketuarve që pranojnë të diskutojnë çështje që lidhen me dhunën kundër grave dhe vajzave me fëmijët e tyre biologjikë vajza **është 20%** (ishte 10% në vlerësimin fillestar dhe 21% në vlerësimin afatmesëm).

Grafiku 6: “në 12 muajt e kaluar, a keni diskutuar çështje që lidhen me parandalimin e DHNGV me...”



Kanalet e zakonshme për të dhënë mesazhe për DHNGV dhe barazinë gjinore

- **Metodat më të zakonshme të përdorura të komunikimit ka të ngjarë të arrijnë audiencën e synuar.** Media sociale (50%), emisionet televizive/ debatet (48%), spotet

televizive, materialet promovuese të tilla si fletëpalosjet (31%) dhe gazetatat (28%), reklamat në radio (20%) dhe trajnimet (19%) vazhdojnë të jenë kanalet më efektive për të shpërndarë informacion që lidhet me parandalimin e dhunës kundër grave.

- **Metodat alternative të komunikimit, të tilla si lojërat sportive, ritet fetare/ekspozitat dhe këngët, mund të jenë më pak efektive në arritjen e një audience të madhe, pavarësisht se mund të jenë të dobishme si pjesë e një fushate më të gjerë që përdor gjithashtu metoda të zakonshme të komunikimit. Përveç kësaj, marshimet kanë demonstruar një impakt të ulët në publik.**

Grafiku 7: “Në 12 muajt e kaluar, a keni dëgjuar për çështje që lidhen me barazinë gjinore ose parandalimin e DHNGV nëpërmjet...”

